

VENDIM
Nr.345, datë 10.8.1992

PËR SHPËRBLIMIN E PUNËS SË PUNONJËSVE

Në zbatim të ligjit nr.7583, datë 13.7.1992 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Paga e punonjësve llogaritet duke u mbështetur në vëllimin e punës, të matur në sasi e cilësi, në kohën e punës dhe në klasifikimin e renditjes së punës.

2. Paga bazë minimale mujore për punonjësit është 675 lekë, e cila është e detyrueshme të zbatohet nga gjithë punëdhënësit.

3. Paga mesatare mujore për vitin 1992, për efekt kontrolli, sipas ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore për sistemin e ndërmarrjeve shtetërore e të institucioneve shtetërore jobuxhetore ose pjesërisht jobuxhetore që ato kanë në varësi, është spas lidhjes që i bashkëngjitet këtij vendimi.

4. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, në bazë të kësaj page mesatare, përcaktojnë pagën mesatare mujore për çdo ndërmarrje shtetërore, institucion shtetëror jobuxhetor ose pjesërisht jobuxhetor, duke ruajtur në shkallë ministrie pagën mesatare mujore të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave në pikën 3 të këtij vendimi.

5. Përjashtimisht për vitin 1992 rritja e pagës mesatare nuk është dhënë në përqindje, meqë u dha kompensimet për frymë të shpenzimeve nga rritja e çmimeve të disa artikujve ushqimorë, të cilat nuk përfshihen në pagë.

6. Ndërmarrja dhe institucioni shtetëror jobuxhetor ose pjesërisht jobuxhetor i caktojnë vetë pagat e punës në vartësi nga mundësitë e tyre, duke ruajtur në shkallë ndërmarrjeje, institucioni shtetëror jobuxhetor ose pjesërisht buxhetor pagën mesatare mujore të përcaktuar nga ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, nga të cilat varen.

7. Paga e drejtorit dhe anëtarëve të këshillit drejtues të ndërmarrjes ose të institucionit jobuxhetor cakohen nga organi që ka kompetencë emërimin e tyre, sipas neni 19 pika 2 të kreut II të ligjit për ndërmarrjet shtetërore.

Raporti i pagave të tyre do të jetë jo më i madh se 1:4 në krahasim me pagën me të ulët të punonjësit.

Anëtarët e Këshillit drejtues dhe drejtori i ndërmarrjes ose institucioni jobuxhetor kanë të drejtë të marrin edhe shpërblim suplementar deri në 5 për qind të shtesës së fitimit të reaktuar, opor jo me shumë se deri në 4 paga mujore në vit. Ky shpërblim jepet me mbylljen e rezultatit vjetor dhe caktohet nga titullari I organit që ka kompetencë emërimin e tyre.

8. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë barazohet për efekt page me ministrin e Financave. Zv.guvernatori i Bankës së Shqipërisë, drejtuesit e bankave të tjera dhe drejtori i institutit të sigurimeve shtetërore barazohen për efekt page me zv.ministrin.

9. Sipas ligjit të ndërmarrjes, institucionet shtetërore jobuxhetore mund të shpërndajnë fitime suplementare për punonjësit jo më shumë se 15 për qind të fitimit të realizuar, vetëm kur disponojnë rezervën përkatëse, por jo më shumë se 2 paga mujore në vit për secilin punonjës.

10. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë ushtrojnë kontroll mbi rritjen e pagës mesatare mujore në ndërmarrjet shtetërore, institucionet shtetërore jobuxhetore dhe pjesërisht jobuxhetore.

- Nëse ndërmarrja shtetërore, institucioni shtetëror jobuxhetor dhe pjesërisht jobuxhetor rritin pagën mesatare mujore deri në 5 për qind mbi pagën mesatare mujore të përcaktuar sipas pikës 4 të këtij vendimi, nuk zbatohet asnjë sanksion.

- Nëse ndërmarrja shtetërore, institucioni shtetëror jobuxhetor dhe pjesërisht jobuxhetor rritin pagën mesatare mujore mbi 5 për qind deri në 8 për qind mbi pagën mesatare mujore të përcaktuar sipas pikës 4 të këtij vendimi, detyrohen të derdhin në buxhetin e shtetit një pjesë të fitimit baraz me 100 për qind të kësaj rritjeje.

- Nëse ndërmarrja shtetërore, institucioni shtetëror jobuxhetor dhe pjesërisht jobuxhetor rritin pagën mesatare mujore mbi 8 për qind deri në 10 për qind mbi pagën mesatare mujore të përcaktuar sipas pikës 4 të këtij vendimi, detyrohen të derdhin në buxhetin e shtetit një pjesë të fitimit baraz me

200 për qind të kësaj rritjeje.

- Nëse ndërmarrja shtetërore, institucioni shtetëror jobuxhetor dhe pjesërisht jobuxhetor rritin pagën mesatare mujore mbi 10 për mbi pagën mesatare mujore të përcaktuar sipas pikës 4 të këtij vendimi, detyrohen të derdhin në buxhetin e shtetit një pjesë të fitimit baraz me 500 për qind të kësaj rritjeje.

11. Për ndërmarrjet, veprimtaria e të cilave është më me humbje të njohur në ligj e që subvencionohen nga shteti (jom për diferencën e çmimeve), ministrinë përkatëse shqyrtojnë programin financiar të tyre dhe caktojnë fondin e pagave për periudhën përkatëse. Për kontrollin e fundit të pagës zbatohen sanksionet e parashikuara në pikën 10.

12. Sanksionet e parashikuara në pikën 10 jepen nga inspektorët e seksionit të financës në rreth (për Tiranën në bashki).

Kundër vendimit mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes së njoftimit të tij, të përgjegjësi i seksionit të financës në rreth (për Tiranën Bashki) dhe kundër vendimit të këtij të fundit mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes së njoftimit të tij, të drejtori i pagave e çmimeve në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, akti i cilit është i formës së prerë.

13. Në pagën mesatare mujore, për efekt kontrolli, sipas pikës 10, nuk përfshihen:

- shpërblimet nga përdorimi i i fitimit të realizuar që u jepen punonjësve;
- kompensimet për frymë të shpenzimeve nga rritja e çmimeve të disa artikujve ushqimorë;
- pagat dhe shpërblimet e këshillit drejtues të ndërmarrjeve dhe institucioneve jobuxhetore;
- Shpërblimet për punën e realizuar në ditët e pushimit, të festave;
- shpenzimet për udhëtime e dieta që u jepen punonjësve brenda ose jashtë vendit;
- shpenzimet për kontributin e sigurimeve shoqërore;
- shpërblimet që u jepen autorëve të shpikjeve e të racionalizimeve, si dhe shpërblimet për arritje të reja teknike ose organizuese, që janë fryt i punës kërkimore me efekte ekonomike;
- honoraret që burojnë nga e drejta e autorit, krijuesit dhe racionalizuesit;
- dëmshpërblimet;

14. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë cakton rregulla praktike për ushtrimin e kontrollit mbi pagën mesatare mujore.

15. Ministria e financave dhe e Ekonomisë rekomandon rregulla për ndërtimin e sistemit të pagave në ndërmarrjet shtetërore dhe institucionet shtetërore e metodika për vlerësimin e vendeve të punës.

16. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë lëshon udhëzim për zbatimin e këtij vendimi.

17. Çdo vendim dhe akt tjetër nënligjor që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 15 gusht 1992.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

**PAGA MESATARE MUJORE PËR EFEKT KONTROLLI SIPAS MINISTRIVE DHE
INSTITUCIONEVE TË TJERA QENDRORE PËR PUNONJËSIT E NDËRMARRJEVE DHE TË
INSTITUCIONEVE JOBUXHETORE PËR VITIN 1992**

Paga mesatare mujore për punonjësit sipas ministrive:

1. Ministria e Industrisë dhe Burimeve Minerare e Energjitike	2.803
2. Ministria e Ndërtimit, e Strehimit dhe e Rregullimit të Territorit	2.544
3. Ministria e Transporteve dhe e Komunikacioneve	2.530
4. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit	2.197
5. Ministria e Kulturës dhe Sporteve	2.171
6. Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit	2.256
7. Ministria e Rendit Publik	2.643
8. Ministria e Turizmit	2.203
9. Ministria e Arsimit	2.167
10. Ministria e Mbrojtjes	2.725

11. Ministria e Tregtisë dhe e Lidhjeve Ekonomike me Jashtë	2.208
12. Drejtoria e Informatikës Ekonomike	2.397
13. Drejtoria e Shërbimit Qeveritar	2.259
14. Banka e Shqipërisë	2.893
15. Banka Kombëtare	2.893
16. Banka Shqiptare e Tregtisë	2.714
17. Banka e Kursimeve	2.698
18. Banka Bujqësore dhe e Zhvillimit	2.751
19. Instituti i Sigurimeve Shtetërore	2.723

Shënim: Paga mesatare mujore për vitin 1992 është llogaritur mbi bazën mesatare të realizuar në vitin 1990, e korrigjuar me shtesat e bëra në pagat me vendime të ndryshme të Këshillit të Ministrave ose të ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore, sipas kompetencave që kanë pasur deri në fund të vitit 1991 dhe realizimet mesatare të pagave të bëra gjatë 6- mujorit të parë të vitit 1992 (ku janë përfshirë edhe kompensimet).